



BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERËN ZNJ.TEFTA SELMANI.**

Drejtorja e Shërbimit Social dhe Drejtorja e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga **Novrus Selmani** me nr. 42222 prot, datë 28.07.2025, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “, VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë!

E ndjera znj.Tefta Selmani ,anëtare e komunitetit egjyptian, prej vitesh vuante nga sëmundje të ndryshme kronike, diabeti tipi 2, zemra dhe tension i lartë. E ndjera jetonte vetëm me bashkëshortin e moshuar në kushte shumë të vështira social-ekonomike, në një banesë të papërshtatëshme për të jetuar e cila nuk plotësonte nevojat bazike për një të moshuar.

Proгноza e vështirë e sëmundjeve, solli që e ndjera znj.Tefta Selmani për një periudhë 6 mujore të paralizohet totalisht. Nga kjo situatë e vështirë shëndetësore, ajo nuk mund të fitonte luftën me sëmundjen dhe ndërroi jetë në datë 03.07.2025, ku shkaku i vdekjes ishte hemoragjia cerebrale.

Prej vitesh, familja është identifikuar dhe mbështetur nga shërbimi social, si familje në nevojë duke e trajtuar me ndihmë ekonomike, duke e përfshirë në programet e strehimit social, përmirësim i banesave të familjeve në nevojë dhe mbështetje me paketa ushqimore-higjieno-sanitare si dhe sigurimi i një karrige me rrota për pamundësit shëndetësore që shfaqte.



Gjatë vizitave në familje, nga strukturat e Shërbimit Social, është vlerësuar situata e vështirë e jetesës që bashkëshorti i të ndjerës ndodhet aktualisht dhe pamundësia ekonomike e tij, e cila i ka akumuluar borxhe për të përballuar shpenzimet e varrimit ndaj subjektit që ka kryer këto shërbime.


Duke u bazuar në historikun, problematikat e rastit dhe vlerësimin social nga strukturat e shërbimit social, pamundësive financiare për të përballuar shpenzimet e varrimit, borxhi i akumuluar, kërkesës së paraqitur nga **z.Novrus Selmani**, drejtorja e Shërbimit Social, propozon të mbështes vetëm me shpenzimet e varrimit, në shumën 44.000 (dyzet e katër mijë) lekë Z.Novrus Selmani.

Bashkëngjitur gjeni:

- 1.Certifikatë familjare.
- 2.Certifikata e vdekjes.
3. Kërkesën nga z.Novrus Selami.
- 4.Dokumenta shëndetësore
5. Faturë tatimore nga subjekti funeral.
- 6.Korrespondenca me Shërbimin Social.
- 7.Fotokopje karte ID
- * 8. Vërtetim pensioni:

DREJTOR I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblani



bashkiaberat@yahoo.com



BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE PËR RASTE TË VEÇANTA ZNJ.MILIKA PRIFTI.**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga **Milika Prifti** me nr. 1155 prot, datë 31.07.2025, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “, VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë!

Znj.Milika Prifti është një e moshuar e cila jeton bashkë me bashkëshortin e saj Velo Prifti. Kjo familje jeton në rajonin nr. 1, lagja “Barrikadë”, të adhurat e tyre janë vetëm pensionet minimale, të cilat në shumicën e rasteve nuk u plotësojnë as nevojat bazike. Për të mos mjaftuar problemet ekonomike, në këtë familje dukshëm evidentohen dhe problemet sociale që kanë. Djali i familjes, rreth të 50-ve, i vetmi që mund të kujdesej për të dy të moshuarit, përdorues alkooli i ka braktisur dhe ka konflikte të shumta me të moshuarit. Rasti në drejtori është referuar nga struktura spitalore, ku znj.Milika është paraqitur me simptoma të një hemoragjie cerebrale dhe nuk ka pasur mundësi për blerjen e medikamenteve të domosdoshme dhe jetike, tashmë e paralizuar dhe këkron kujdes të vecantë. Prej dy javvë edhe bashkëshorti, i moshuar, ka kryher ndëryrje kardilogjike dhe nuk mund të kujdeset në vazhdim për rëhabilitimine zonjës. Pas vlerësimit të nevojave, e moshuara ka nevojë imediate për terapi fizike, fizioterapi.



Prej vitesh, familja është identifikuar dhe mbështetur nga shërbimi social, si familje në nevojë duke e trajtuar me ndihmë ekonomike, duke e përfshirë në programet e strehimit social, dhe mbështetje me paketa ushqimore-higjieno-sanitare si dhe sigurimin e një karrige me rrota për pamundësit shëndetësore që shfaqte e moshuara.

Gjatë vizitave në familje, nga strukturat e Shërbimit Social, është vlerësuar situata e vështirë e jetesës që çifti i bashkëshortëve ndodhet aktualisht dhe pamundësia ekonomike e tyre, e cila i ka akumuluar borxhe për të përballuar rehabilitimin e tyre.

Duke u bazuar në historikun, problematikat e rastit dhe vlerësimin social nga strukturat e shërbimit social, pamundësive financiare për të përballuar kostot e sëmundjes dhe nevojën për rehabilitim, drejtoria e Shërbimit Social, propozon të mbështes znj. Milika Prifti në shumën 40.000 (dyzet mijë) lekë.

Bashkëngjitur gjeni:

1. Certifikatë familjare.
2. Epikrizë përcjellëse.
3. Kërkesën nga z. Velo Prifti.
4. Dokumenta shëndetësore
6. Korrespondenca me Shërbimin Social.
7. Fotokopje karte ID
8. Vërtetim pensioni.

DREJTOR I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

RELACION

MBI MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PËR FAMILJEN E Z.ARMANDO SHKURTI

Të nderuar Këshilltarë!

Në kuadër të mbështetjes dhe zbatimit të politikave të strehimit që Bashkia Berat ofron për familjet e pastreha si dhe me probleme sociale dhe ekonomike, bazuar në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social” neni 2, pika 34, 45, neni 33, 34, VKM nr.459. datë 03.07.2019 “Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, po ju sjellim për miratim bonusin e qirasë për familjen e z.Armando Shkurti.

Sipas shkresës nr.4015 prot. datë 18.07.2025 “Kërkesë për mbështetje të familjes Shkurti në programin e subvencionimit të qirasë” të Drejtorisë së Shërbimit Social të Bashkisë, kjo familje i përket Komunitetit Egjyptian e përbërë nga 4 anëtarë, është identifikuar si familje në nevojë strehimi si dhe me problematika të ndryshme sociale dhe ekonomike.

Prej vitit 2023 familja Shkurti është identifikuar si familje në nevojë dhe me problematika të ndryshme sociale, pasi kryefamiljari prej vitesh ka qënë përdorues i lëndëve narkotike dhe nuk kryente asnjë punë duke vështirësuar situatën social – ekonomike të familjes. Bashkëshortja e ndodhur në situata të vështira social - ekonomike është larguar disa nga bashkëshorti për të jetuar me prindërit e saj por edhe atje në kushte shumë të vështira ekonomike dhe në mungesë të ambienteve të strehimit për të qëndruar në këtë banesë.

Kryefamiljari ka nisur rehabilitimin prej 1 viti me metadon por ende nuk është i aftë për punë. Aktualisht kjo familja trajtohet me ndihmë ekonomike.

Aktualisht kjo familje jeton me qira në një banesë të ndodhur në lagjen “28 Nëntori” me vlerë qiraje prej 17,000 lekë/muaj, sipas Kontratës së Qirasë Nr.repertori:198, Nr.Koleksioni:90, datë 10.02.2025.

Nga sa më sipër kërkojmë miratimin e bonusit të qirasë për familjen Shkurti për periudhën 01.10.2025 - 31.12.2025 në vlerën 51,000 lekë.

DREJTOR I MROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

Sokol Toska



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E MENAXHIMIT FINANCIAR DHE TË ARDHURAVE

Berat, më /12/2025

RELACION

“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2027-2029”

Të nderuar këshilltarë !

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, neni 34 pika 6, neni 41 pika 1, neni 54 pika dh, neni 64 pika c të Kreut X, i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33, 34, 35 36, 37, 38, 39. Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; me ndryshimet e bëra. Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 9 datë 20.03.2018 “ Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”,

- Ju paraqesim për miratim Kalendarin “Për procedurat standarte për përgatitjen e kërkesave të programit buxhetor afatmesëm 2027 -2029” sipas tabelës bashkëlidhur.

Ju faleminderit !

Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

Rovena Shehu